




KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno:	21.07 20 21	
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
1-030-40169		



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.  
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOISNABEVANJE D.D.  
**PRISHTINA**

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

E lidhur, ndërmjet :

Komunës së Lipjanit, përfaqësuar nga z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit ( në vazhdim të tekstit Komuna) dhe

Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësit SH.A Prishtina, Prishtinë rr. Hazir Shala nr.4 përfaqësuar nga U.d. Kryeshefi Ekzekutiv z.Sokol Xhafa (në vazhdim të tekstit Kompania) :

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së këtij Memorandumi të Mirëkuptimit është **bashkëfinancimi i përbashkët** në Projektin për blerjen e tri (3) popave të ujit për përdorim në territorin e Komunës së Lipjanit nga Kompanisë Rajonale të Ujësjetlësit SH.A Prishtina.

### Neni 2 Obligimet e Komunës

1. Komuna me anë të këtij Memorandumi merr obligim të participojë - bashkëfinancojë me **6.000 €** (gjashtë mijë euro), blerjen e tri (3) popave të ujit në mënyrë që të funksionalizohen dhe të hynë në përdorim për shfrytëzim nga qytetarët e Komunës së Lipjanit.
2. Specifikimin teknik të tri (3) popave të ujit do të bëjë Komuna e Lipjanit.
3. Shuma e cekur në par. 1 të këtij neni, do të ndahet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit - kategoria ekonomike - fondi për bashkëfinancim me donatorë.

### Neni 3

#### Obligimet e Kompanisë

1. Me anë të kësaj marrëveshje, Kompania merr obligim që realizoj kyqjen në sistem të tri (3) popave të ujit duke përfshirë pajisjet e nevojshme si dhe punën për funksionalizimin e përgjithshëm të pompave të ujit.
2. Kostja e shumës së shpeznimeve sipas paragrafit 1. të këtij neni e merre për obligim Kompania Rajonale të Ujësjellësit SH.A Prishtina

### Neni 4

#### Zhvillimi i procedurave të prokurimit

1. Procedurat e prokurimit do të zhvillohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik, të cilat do të udhëhiqen nga Komuna e Lipjanit.
2. Komuna do të procedojë me pagesa vetëm pas pranimit të raportit përfundimtar të puneve nga menaxheri i Kontratës.

### Neni 5

#### Ndryshimi dhe Përfundimi

1. Ky Memorandum Mirekuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim.
2. Ky Memorandum Mirekuptimi mund të jete zgjidhur nga çdo palë me kushtin që të njoftojë palën tjetër me shkrim 30 (tridhjetë) ditë përpara.

### Neni 6

#### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palet do të përpiqen të zgjidhin në mënyrën më të përshtatshme çdo mosmarrëveshje që buron nga ky Memorandum Mirekuptimi.

### Neni 7

#### Hyrja në fuqi

1. Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.
2. Ky Memorandum është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.

Z. Imri Ahmeti  
Kryetar i Komunes së Lipjanit



Z. Sokol Xhafa  
U.d Kryeshef Ekzekutiv i i KUR "Prishtina" sh.a

A handwritten signature in blue ink, corresponding to the name Z. Sokol Xhafa.

2021